



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE ,TRANSPORTIT DHE SHËRBIM

## RELACION

**MBI MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIMIN E BASHKISË NË PROJEKTIN “PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA”.**

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat e ka prioritet të saj strehimin e familjeve në nevojë të pa favorizuara e me probleme sociale .

Për ti ardhur ne ndihmë kësaj shtrese prej dy vitesh Bashkia Berat është bërë bashkëfinacuese në masën 20 % të koston totale të projektit “ Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“.

Për vitin 2020 nga zbatimi i këtij projekti përfituan përmirësim të banesave 14 familje me kosto totale të projektit në vlerën 11,930,760 leke .

Ndërsa për vitin 2021, përfituan përmirësim të banesave 36 familje me kosto totale të projektit në vlerën 33,347,697 leke .

Bashkia Berat edhe për këtë vit ju përgjigj pozitivisht kërkesës së Ministrisë së Financave “Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2022 ”.

Nisur nga numri i madh i familjeve ne nevojë të identifikuar nga ana jonë, banesat e të cilave janë të amortizuara dhe jashte kushteve teknike, ne edhe këtë vit po pregatisim dosjen për të aplikuar për këtë projekt.

Një nga kushtet që duhet të plotësojë Bashkia për t’u kualifikuar është përqindja e bashkëfinancimit për projektin, që për këtë vit për bashkine tonë ka ndryshuar.

Bazuar në tabelën nr.2 “ Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit në varësi të nivelit të të ardhurave vjetore për fytyrë të cilat për vitin 2021“ të termave të referencës të projektit për Bashkinë Berat , janë 4,004 mijë lekë dhe përqindja maksimale e financimit nga buxheti i shtetit është deri në 70% të koston totale të projektit dhe pjesa tjetër 30% do të mbulohet nga fondet e bashkisë.

Nga sa më sipër, ne ju propozojmë të miratoni financimin në masën 30 % të koston së projektit “ Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara“.

**Drejtore i M.C.P.T.SH**

**Erlin KUÇI**

Adresa: Blvd. “Republika”, Berat 5001. Shqipëri, Tel /00355(0) 2 32 34 935, eëbsite: [www.bashkiaberat.gov.al](http://www.bashkiaberat.gov.al), Email : [bashkiaberat@yahoo.com](mailto:bashkiaberat@yahoo.com)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

RELACION

**MBI MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË BERAT.**

Të nderuar këshilltarë!

Plani i Integritetit për Bashkinë Berat është hartuar në kuadër të projektit “Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor”, i financuar nga Projekti STAR 3. Projekti STAR 3 zbatohet nga UNDP në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, financohet nga Bashkimi Evropian dhe qeveritë e Suedisë dhe Zvicrës, UNDP në Shqipëri dhe Qeveria Shqiptare.

Bashkia Berat u angazhua në planifikimin e integritetit si një mundësi për të rritur njohuritë dhe aftësitë institucionale, për të identifikuar dhe vlerësuar risqet e cenueshmërisë së integritetit dhe pasur instrumente efektive për të forcuar rezistencën institucionale ndaj shkeljeve të integritetit dhe korrupsionit. Plani i Integritetit përfaqëson një dokument të rëndësishëm sa strategjik aq edhe operacional për forcimin e integritetit institucional. Plani shërben si instrument efektiv për luftën antikorrupsion në nivelin e institucionit duke identifikuar, vlerësuar dhe adresuar risqet e proceseve kryesore të punës së institucionit në lidhje me aspektet e integritetit (transparenca, llogaridhënia, efektiviteti, eficaenca, pjesëmarrja qytetare etj).

Plani i Integritetit për bashkinë e Beratit është përgatitur me pjesëmarrjen e të gjithë stafit të bashkisë, të udhëhequr nga Grupi i Punës për Integritet dhe me asistencën teknike të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Dokumenti është produkt i një procesi gjithëpërfshirës i planifikimit të integritetit dhe vlerësimit të riskut, duke ndjekur Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore - MVRI (IDM, 2019). Proces i planifikimit të integritetit institucional përfshiu stafin e bashkisë të angazhuar në nivele të ndryshme organizative dhe fusha të ndryshme funksionale të bashkisë, përmes diskutimeve në fokus grup, pyetësorit të vetëvlerësimit, rishikimit të kuadrit të brendshëm rregullator dhe rishikime të studimeve të ndryshme. I gjithë ky informacion ka qenë i vlefshëm për të identifikuar risqet dhe fushat me cenueshmëri të lartë për shkelje të integritetit.

Ju ftoj ta votoni Planin e Integritetit të Bashkisë Berat, sipas dokumentit bashkangjitur.

Ju faleminderit,

**KRYETARI I BASHKISË**

**Ervin DEMO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

RELACION

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT ME QËLLIM ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE NË BURDULLIAS, BERAT**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Bashkia Berat do të nisë shpronësimin për interes publik për pasuritë nr. 4/43, 4/27, 4/41 të llojit “truall”, në Zonën Kadastrale nr. 8501, me qëllim zgjerimin e varrezave publike në Burdullias, Berat.

Bashkia Berat ka bërë përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e hapësirave të lira të tokës, për krijimin e kushteve të përshtatshme për tu përduror, për banorët e kësaj zone që ndërrojnë jetë. Realizimi i këtij investimi është një domosdoshmëri, për shkak të mungesës së sipërfaqjeve të lira në varrezat ekzistuese, duke shkaktuar problem me menaxhimin e rasteve kur banorë të kësaj zone ndërrojnë jetë.

Kur numri i vdekjeve është rritur në mënyrë të ndjeshme edhe për shkak të pandemisë, kërkesa për zgjerimin e varrezave është sa e nevojshme dhe që kërkon reagim të menjëhershëm, si një rast emergjence pasi janë ezauruar të gjitha mundësitë për shfrytëzimin maksimal të vendeve në varrezat ekzistuese.

Rezultoni se sipërfaqet pranë varrezave ekzistuese janë me status privat, të llojit “truall” të regjistruara me nr.pasurie 4/27 vol 13, fq 243, zk 8501, nr.pasurie 4/43, vol 14, fq 219, zk 8501 dhe nr.pasurie 4/41 vol 13, fq 242, zk 8501, konfirmuar nga zyra vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Berat.

Për këto pasuri rezultoni të jenë bashkëpronarë z.Adriatik Qemal Bego, znj. Migena Haxhi Peshtani, z. Qemal Avdyl Bego dhe z. Robert Qemal Polo për pasurinë e llojit “truall”, me nr. 4/27, me sipërfaqje të përgjithëshme 3200 m<sup>2</sup>, ndodhur në Zonën Kadastrale 8501, me indeks harte BR-D-5.

Për pasurinë me nr. 4/41, e llojit “truall”, me sipërfaqje të përgjithëshme 1800 (nga të cilat truall 1800 m<sup>2</sup> ndërtesë 67 m<sup>2</sup>) ndodhur në Zonën Kadastrale 8501, me indeks harte BR-D-5 znj. Feride Ibrahim Peshtanaku, znj. Migena Peshtanaku dhe znj.Morfata Peshtanaku dhe për pasurinë me nr. 4/43 z. Agim Medi Nova, e llojit “truall”, me sipërfaqje të përgjithëshme 2600 m<sup>2</sup> ndodhur në Zonën Kadastrale 8501, me indeks harte BR-D-5.

Për këto arsye, në mbështetje të ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar si dhe VKM nr. 127 datë 23.03.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar sipas nenit 8 gërma c), bashkëlidhur ju përcjellim dokumentacionin si më poshtë:

- Lista e pronarëve të pasurive private, pasuritë e të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit.

Në bazë të nenit 10 pika c) e ligjit nr. 8561 datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshur, si dhe informacionit të dërguar nga zyra vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Berat, si me poshte lista e pronarëve të pasurisë pronë private që shpronësohet.

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	ZK	Konfirmuar ASHK	Sip. që shpronësohet m <sup>2</sup>
1	Agim Medi Nova	4/43	Truall	8501	PO	2600
2	Adriatik Qemal Bego Migena Haxhi Peshtani Qemal Avdyl Bego Robert Qemal Polo	4/27	Truall	8501	PO	3200
3	Feride Ibrahim Peshtanaku Migena Peshtanaku Morfata Peshtanaku	4/41	Truall	8501	PO	1800 ( nga te cilat truall 1800 m <sup>2</sup> ndertesë 67m <sup>2</sup> )

Në këto kushte kërkojmë miratimin tuaj për nisjen e procedurave të shpronësimit për interes publik për Objektin. “Zgjerimin e Varrezave publike Burdullias”

Fondi për përballimin e koston financiare të shpronësimit do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë.

Faleminderit!

Kryetar i Komisionit të Shpronësimeve.

**Luçiano Bojaxhiu**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA  
ZNJ. XHEMILE HAMETI**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Znj. Xhemile Hameti me nr. 87 prot, datë 27.01.2022, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.94, datë 28.12.2021 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë!

Familja Hameti është një familje që jeton në Nj.Adm Sinjë, fshati Osmenzezë, e përbërë nga 4 anëtar. Z.Jemin është K/familjari i kësaj familje, bashkëshortja Xhemile dhe dy fëmijët përkatësisht të moshës 12 vjeç dhe 10 vjeç (bashkëngjitur gjeni çertifikatën familjare dhe kopje të kartave të identitetit).

Kjo familje jeton në një banesë të tipologjisë 2+1, në kushte shumë të vështira e cila me rreshjet e fundit të shiut është dëmtuar dukshëm dhe pengon anëtarët e kësaj familje dhe fëmijët të bëjnë një jetesë normale (bashkëngjitur gjeni foto nga banesa).

Përpost problemeve që ka në banesë familja Hameti, ka dhe vështirësi shumë të theksuara social-ekonomike, si pasojë e mungesës së të ardhurave si dhe zonës së thellë ku jetojnë, e cila është larg shërbimeve dhe nuk të ofron asnjë mundësi për t’u integruar në tregun e punës. Të vetmet të ardhura që ka familja Hameti, është pagesa e ndihmës ekonomike, në masën 5.946 (pesë mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) lekë dhe ato pak prodhime bujqësore dhe blegtorale që ka familja,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të cilat nuk mjaftojnë as për plotësimin e nevojave personale ( bashkëngjitur gjeni vërtetimin e masës së ndihmës ekonomike).

Kushtet e vështira social-ekonomike, problemet e banesës, pa mundësitë për të pasur pranë shërbimet, po e vështirësojnë shumë jetesën e kësaj familje. Për të mos mjaftuar të gjitha problematikat e mësipërme, familjes Hameti i duhet të përballet edhe me problemet e shëndetit mendor të Znj. Xhemile, e cila është diagnostikuar në vitin 2020 me çregullimin afektiv (bashkëngjitur gjeni dokumentacionet mjekësor).

Periodha e vështirë në të cilën po kalon familja Hameti, çdo ditë behet me e theksuar në mirë rritjen dhe shkollimin e fëmijëve, jetesën normale dhe kurimin e bashkëshortes, pasi të ardhurat që kanë janë tepër të kufizuara. Gjatë verifikimit social-ekonomik në familjen Hameti, konstatoam që familja ka nevojë të menjëhershme për mbështetje finaciare, për përballimin e nevojave bazike si ngrohje, kurim të bashkëshortes, izolimin e çatisë në masën 40.000 (dyzet mijë) lekë (bashkëngjitur gjeni vleresimin social-ekonomik, kërkesën pranë zyrës me një ndalesë) .

**DREJTORI I KOMANDUAR I SHËRBIMIT SOCIAL**

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION**

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA  
ZNJ. XHEMILE HAMETI**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Znj. Xhemile Hameti me nr. 87 prot, datë 27.01.2022, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.94, datë 28.12.2021 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2022 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë!

Familja Hameti është një familje që jeton në Nj.Adm Sinjë, fshati Osmenzezë, e përbërë nga 4 anëtar. Z.Jemin është K/familjari i kësaj familje, bashkëshortja Xhemile dhe dy fëmijët përkatësisht të moshës 12 vjeç dhe 10 vjeç (bashkëngjitur gjeni çertifikatën familjare dhe kopje të kartave të identitetit).

Kjo familje jeton në një banesë të tipologjisë 2+1, në kushte shumë të vështira e cila me rreshjet e fundit të shiut është dëmtuar dukshëm dhe pengon anëtarët e kësaj familje dhe fëmijët të bëjnë një jetesë normale (bashkëngjitur gjeni foto nga banesa).

Përpost problemeve që ka në banesë familja Hameti, ka dhe vështirësi shumë të theksuara social-ekonomike, si pasojë e mungesës së të ardhurave si dhe zonës së thellë ku jetojnë, e cila është larg shërbimeve dhe nuk të ofron asnjë mundësi për t’u integruar në tregun e punës. Të vetmet të ardhura që ka familja Hameti, është pagesa e ndihmës ekonomike, në masën 5.946 (pesë mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) lekë dhe ato pak prodhime bujqësore dhe blegtorale që ka familja,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


të cilat nuk mjaftojnë as për plotësimin e nevojave personale ( bashkëngjitur gjeni vërtetimin e masës së ndihmës ekonomike).

Kushtet e vështira social-ekonomike, problemet e banesës, pa mundësitë për të pasur pranë shërbimet, po e vështirësojnë shumë jetesën e kësaj familje. Për të mos mjaftuar të gjitha problematikat e mësipërme, familjes Hameti i duhet të përballet edhe me problemet e shëndetit mendor të Znj. Xhemile, e cila është diagnostikuar në vitin 2020 me çregullimin afektiv (bashkëngjitur gjeni dokumentacionet mjekësor).

Periudha e vështirë në të cilën po kalon familja Hameti, çdo ditë behet me e theksuar në mirë ritjen dhe shkollimin e fëmijëve, jetesën normale dhe kurimin e bashkëshortes, pasi të ardhurat që kanë janë tepër të kufizuara. Gjatë verifikimit social-ekonomik në familjen Hameti, konstatoam që familja ka nevojë të menjëhershme për mbështetje financiare, për përballimin e nevojave bazike si ngrohje, kurim të bashkëshortes, izolimin e çatisë në masën 40.000 (dyzet mijë) lekë (bashkëngjitur gjeni vleresimin social-ekonomik, kërkesën pranë zyrës me një ndalesë).

**DREJTORI I KOMANDUAR I SHËRBIMIT SOCIAL**

Piro Xheblati







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

## RELACION

### MBI MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QE PËRFITOJNË BONUS QIRAJE

**Të nderuar Këshilltare !**

Në kuadër të mbështetjes dhe zbatimit të politikave të strehimit që Bashkia Berat ofron në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të pikës 34,45 nenit 2, neni 33,34 të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", vkm nr.459, datë 3.07.2019 "Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", për qytetarët në nevojë për t'u strehuar, po ju sjellim listën e kërkesave për bonus strehimi, sipas formatit të kërkuar nga ministria përgjegjëse për strehimin, shoqëruar me kostot financiare për çdo familje dhe listën e detajuar të familjeve përfituese. Theksojmë se, bazuar në legjislacionin në fuqi, përfitojnë bonus strehimi nga buxheti i shtetit, vetëm ato familje që mbulojnë pjesën e mbetur të qerasë me të ardhurat e tyre, ose nëpërmjet financimit të bashkisë.

Komisioni i Strehimit i mbledhur me datë 17.02.2022 mori në shqyrtim të gjitha kërkesat e bëra për bonus strehimi nga 42 kërkesa nga familjet e pastreha dhe mbas shqyrtimit të dosjes miratoj listën e familjeve që u kualifikuan të përbërë nga 40 familje dhe s'kualifikoj për mungesë dokumentacioni dhe kriteresh 2 kërkesa.

Bashkëlidhur lista e familjeve përfituese.

Drejtore  
Erlin Kuçi

LISTA E PERFITUESVE TE SUBVENCIONIMIT TE QIRASE PER BASHKINE BERAT PER VITIN 2022

Nr	Emer/Atesi/Mbiemer	Kategoria sipas nenit 16,te ligjit nr.22/2018	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit	Sipërfaqja e apartamentit	Qiraja mes e apart.në treg për strukturën që I takon familjes .	Te ardhurat familjare mujore.	Kategoria (sipas pikës 45,e nenit 2,të ligjit 22/2018)	Aftësia përballuese sipas nenit 3 të ligjit në%	Qiraja e përballueshme sipas nenit 3 të ligjit (g*j)	Subvencionimi në muaj(g-k)	Subvencionimi që mbulohet nga bashkia	Shuma që kërkohet nga buxheti I shtetit
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n
1	Sulejman Avni Dyrmishi	Çift pensionistesh	2	1+1	60	10.000	15.316	sh.te ulet	15	2.297	7.703	46.224	46.224
2	Gezim Ahmet Elezi	Banesa rrezik rreshqitje	4	2+1	80	15.000	26.640	sh.te ulet	15	3.996	11.004	66.024	66.024
3	Armela Asim Agalliu	Banesa rrezik rreshqitje	3	1+1	60	12.000			15		12.000	68.129	68.129
4	Hasan Myftar Baci	Banesa rrezik rreshqitje	2	1+1	52	11.000	26.106	sh.te ulet	15	3.916	7.084	42.504	42.504
5	Kamela Myslim Saçdanaku	K/fam me femije	2	1+1	53	12.000	35.460		15	5.319	6.681	40.086	40.086
6	Zamira Ali Çakaj	E papune Komuniteti	5	1+1	54	9.000					9.000	54.000	54.000
7	Emiljan Shaqir Mjeshtri	Egjiptian	5	1+1	80	5.000	26.640	sh.te ulet	15	3.996	1.004	6.024	6.024
8	Beqir Sabri Mbrakulli	PAK	3	1+1	52	10.000					10.000	60.000	60.000
9	Shpresa Myqerem Kapllan	Perkrahje sociale K.Egjiptian,te mitur ne konflikt	3	1+1	57	12.000					12.000	66.000	66.000
10	Gezim Ramis Gjata		4	2+1	51,8	14.000					14.000	77.000	77.000










11	Mimoza Fiqiri Hoxha	Perkrahje sociale	1	1+1	50	10.000					10.000	60.000	60.000
12	Redinel Fatbardhe Vrioni	PAK	5	2+1	68,5	13.000	26.640	sh.te ulet	15	3.996	9.004	54.024	54.024
13	Irma Ali Isaj	PAK	4	1+1	62	11.000					11.000	66.000	66.000
14	Robert Sami Gega	.K.Egjiptian	2	1+1	60	8.000					8.000	45.935	45.935
15	Naile Fatmir Kapinova	Pagese papunesie	1	1+1	52,7	12.000	0				12.000	64.286	64.286
16	Shana Rexhep Senka	PAK 2 Persona	5	1+1	50	11.000					11.000	66.000	66.000
17	Hetem Teki Gishto	Pensioniste	2	1+1		13.000	15.895		15	2.384	10.616	63.696	63.696
18	Ermini Gaqi Marini	PAK	1	1+1	60	12.000					12.000	66.000	66.000
19	Anila Sherif Pasho	PAK	1	Garsonier	20	2.000					2.000	12.000	12.000
20	Selim Tafil Mahmutaj	PAK	1	1+1	52	13.000					13.000	78.000	78.000
21	Edjana Osman Etemaj	PAK	6	1+1	54,3	10.000					10.000	55.000	55.000
22	Bilbil Sali Ruci	PAK, te dy	2	1+1	60	12000					12.000	72.000	72.000
23	Burbuqe Arshin Elezi	PAK 2 Persona	2	1+1	60	13000					13.000	78.000	78.000
24	Lavdije Qazim Gjata	PAK.K.Egjiptian	7	2+1	80	16.000	-			-	16.000	96.000	96.000
25	Naile Fatmir Kapinova	Pagese papunesie	1	1+1	52,7	12.000					12.000	64.285	64.285
26	Barjam Sali Bacevani	Pensioniste	2	1+1	51,9	13.000	35.790		15	5.369	7.632	91.584	91.584
27	Liljana Livan Merdani	Pensioniste	1	1+1	58	13.000	16.099		15	2.415	10.585	61.592	61.592
28	Ilirjana Hajredin Mahilaj	Pensioniste	1	1+1	40	12.000	8.410		15	1.262	10.739	64.072	64.072
29	Aurora Vangjel Shkurta	K/fam me femije	3	1+1	58	10.000					10.000	53.712	53.712
30	Brunilda Bexhet Bixheku	Viktme trafikimi	6	1+1	43	12.000					12.000	64.286	64.286
31	Eglantina Idajet Mbersi	K/Ffam femije	3	1+1	35	9.400					9.400	56.400	56.400
32	Eglantina Demir Shpata	K/Ffam femije	3	1+1	63	12.000					12.000	72.000	72.000
33	Anisa Nikollaç Çerçizi	K/Ffam femije	4	1+1	63,8	12.000					12.000	72.000	72.000
34	Klajdi Sulo Qose	I papune	1	1+1		9.000					12.000	47.250	47.250
35	Ervin Guri Çili	Fam me te ardhura te ulta	2	1+1	53	13.000	26.640	sh.te ulet	15	3.996	9.004	54.024	54.024
36	Zenel Mehmet Hoxhallari	K.Egjiptian	3	1+1		12.000	26.640	sh.te ulet	15	3.996	8.004	40.020	40.020


37	Besmir Agim Dalipi	K.Rom	3	1+1	55	12.000					12.000	72.000	72.000
38	Artur Hilmi Hetemaj	K.Egjiptian 2 PAK	7	2+1	58	12.000					12.000	63.000	63.000
39	Emiljan Luan Etetaj	K.Egjiptian	3	1+1	53,7	12.000					12.000	63.000	63.000
40	Violeta Sadushi	K.Egjiptian Perkrahje Sociale	1	1+1	43	80.000					8.000	44.000	44.000
											2.386.157	2.386.157	

### KOMISIONI I STREHIMIT

Kryetar Luçiano Bojaxhiu



Erlin Kuçi




Meleqe Spahiu



Piro Xheblati



Mirel Konomi




Joana Melëngu




Kliti Koroni



Admir Grëmbi




Ali Kandarxhiu



Besmir Dalipaj



Kastriot Dullaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT  
“QYTETAR NDERI PAS VDEKJES ” ARJAN PUSHI

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat, si një ndër prioritetet e saj, ka dhe vlerësimin e personave me merita dhe kontribute të veçanta për vendin, përkushtimin ndaj Republikës së Shqipërisë, interesave kombëtare, shoqërisë dhe komunitetit. Për këtë, ne si institucion drejtohem nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 54, pika “m”, Ligji nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, date 19.02.2015), dhe VKB nr.29, datë 04.07.2003 “Aprovim Titujsh Nderi” me kërkesë të një grupi qytetarësh të qytetit të Beratit, më datë 15.02.2022, me nr.885 Prot. për Doktor Arjan Pushin, me profesion mjek, ku në kushtet e Pandemisë së Covid 19, duke ushtruar profesionin e mjekut, i përballuar me një numër të madh të infektuarish me virus, ku dhe ai u infektua dhe për këtë shkak ndërroi jetë; propozon dhënien e titullit të nderit për këtë doktor.

Z.Arjan Pushi, ka lindur në qytetin e Beratit, ku dhe ka përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme Babë Dudë Karbunara, me rezultate të shkëlqyera, e cila i dha mundësinë për të fituar të drejtën për të studiuar mjekësi të përgjithshme. Studimet e larta i kreu në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës me po të njëjtën përgjegjshmëri dhe rezultate të larta.

Në periudhën 1997-1998, ka kryer shkollën pasuniversitare të thellimit shkencor pranë Fakultetit të Mjekësisë në Tiranë, duke mbrojtur tezën shkencore për mjekimin Hydroxyurea në sëmundjen e Drepanocitozes.

Në vitin 1999 ka mbrojtur studimin shkencor “ Rezultatet e Mjekimit me Hydroxyurea, në të sëmurët me sëmundjen e Drepanocitozes” si dhe ka fituar gradën shkencore “ Doktor i Shkencave”.

Z.Arjan ka ofruar shërbimin e tij edhe në fushën e mësimdhënies, pranë Fakultetit të Mjekësisë në Tiranë, si pedagog i brendshëm i hematologjisë. Në vlerësim të punës së gjatë dhe shumë cilësore si pedagog i hematologjisë, aktivitetit intesiv shkencor dhe punës me nivel të lartë shkencor e profesional me të sëmurët në Shërbimin e Hematologjisë, ka marrë titullin “ Profesor i Asociuar”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

Ka qënë iniciator dhe krijues në shërbimin tonë të skemave të reja të mjekimit për leukemite, për limfomat si dhe për mielomat. Gjithashtu, ka qënë pjesëmarrës në Kongresin European të Hematologjisë në Amsterdam, Stokholm, Milano, Pragë, Berlin, Barcelonë, Stamboll, dhe Angli.

Ai ishte i pari anëtar shqiptar i “Shoqatës Evropiane të Hematologjisë”. Në vazhdim të kësaj, ka qënë deri në momentet e fundit President i Shoqatës Shqiptare të Hematologjisë. Gjithashtu, shkrimet dhe studimet e tij janë botuar në revistat hematologjike më prestigjioze në Evropë dhe Botë, si dhe në revista shqiptare.

Profesor Arjan Pushi, ka ofruar kontributin e tij si pedagog në universitet, kërkues shkencor në fushen e mjekësisë, botues studimesh e librash, si dhe në shërbim mjekësor dhe ndjekje të pacientëve hematologjik, në Shërbimin Universitar të Hematologjisë në Tiranë.

Për sa më sipër, propozojmë:

Të miratohet propozimi i dhënies së titullit ‘Qytetar Nderi pas Vdekjes’  
Z, Arjan Pushi.

Faleminderit!

DREJTORI  
**Majlinda RAMAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT “NDER  
I QYTETIT PAS VDEKJES” Z, JOSIF DËNA

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat, si një ndër prioritetet e saj, ka dhe vlerësimin e personave me merita dhe kontribute të veçanta për vendin, përkushtimin ndaj Republikës së Shqipërisë, interesave kombëtare, shoqërisë dhe komunitetit. Për këtë, ne si institucion drejtohem nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 54, pika “m”, Ligji nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, date 19.02.2015), dhe VKB nr.29, datë 04.07.2003 “Aprovim Titujsh Nderi”, me kërkesë të Këshillit Rajonal të Urdhërit të Mjekut, më datë 18.01.2022 me nr.305 Prot. për Z, Josif Dëna, me profesion mjek, ku në kushtet e Pandemisë së Covid 19, duke ushtruar profesionin e mjekut edhe pas daljes në pension të tij, i përballuar me një numër të madh të infektuarish me virus, ku dhe ai u infektua dhe për këtë shkak ndërroi jetë, propozon dhënien e titullit të nderit për këtë doktor. Z. Josif Dëna shquhet për kontribute në fushën e mjekësisë, specialist endokrinolog në Spitalin Rajonal dhe Poliklinikën e Specialiteteve Berat, si edhe në atë të sferës së kërkimeve dhe botimeve shkencore; si depistime të të sëmurëve diabetik dhe botime artikujsh studimor në Buletinin e Shkencave Mjekësore; me ndjenja humanizmi për shërbime edhe në kauza të tjera; me cilësi patriotizmi për të bërë të njohur vlerat e qytetit tonë përtej kufirit; si dhe me detyra të rëndësishme në nivel përfaqësimi të autoritetit shqiptar.

Z. Josif Dëna, ka lindur në Maleshovë të Përmetit. Në moshë të hershme familja e tij u zhvendos për të jetuar përfundimisht në qytetin e Beratit. Përfundoi me rezultate të shkëlqyera shkollën e mesme të përgjithshme dhe si rezultat fitoi të drejtën për të studiuar mjekësi. Studimet e larta i kreu në fakultetin e mjekësisë, në Universitetin e Tiranës. Pas përfundimit të studimeve në mjekësi të përgjithshme, Z, Josif kreu specializimin për Endokrinologji në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë si dhe një kualifikim një mujor në spitalin Hypokrates, Selanik, Greqi.

Në janar 1973 ka filluar punë si mjek i përgjithshëm, në Spitalin e Beratit. Për shumë kohë Z, Josif ka mbajtur detyrën e përgjegjës të Qendrës Shëndetësore, Berat. Ai ka dhënë kontributin e tij jo vetëm në detyrën e mjekut, por edhe të mësimdhënësit, me eksperiencën pedagogjike në shkollën e mesme të infermierisë Berat, si dhe në Universitetin Kristal. Ka marrë pjesë në shumë konferenca në lidhje me endokrinologjinë brenda dhe jashtë vendit, duke kryer aktivitete shkencore, si depistime



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

të të sëmurëve diabetik dhe botime artikujsh studimor në Buletinin e Shkencave Mjekësore. Të gjithë formimin e tij Z, Josif e vuri në funksion të pacientëve, nxënësve dhe studentëve, një mishërim ky i anës teorike me atë praktike, duke ndërthurur shumë mirë të dyja pjesët dhe vendosjen e tyre në dispozicion dhe në të mirë të qytetarëve të Beratit për 40 vjet.

Z. Josif Dëna, gjatë punës së tij ka dalluar për shërbim profesional, human dhe gatishmëri. Ai ka shërbyer pa përtuar edhe gjatë daljes në pension për t'u ardhur në ndihmë të sëmurëve dhe nevojave të institucioneve mjekësore.

Për sa më sipër, propozojmë:

Të miratohet propozimi i dhënies së titullit ‘Nder i Qytetit pas Vdekjes’  
Z, Josif Dëna.

Faleminderit!

DREJTORI  
Majlinda Ramaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES SË TITULLIT “NDER  
I QYTETIT PAS VDEKJES ” GËZIM LAMAJ

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat, si një ndër prioritetet e saj, ka dhe vlerësimin e personave me merita dhe kontribute të veçanta për vendin, përkushtimin ndaj Republikës së Shqipërisë, interesave kombëtare, shoqërisë dhe komunitetit. Për këtë, ne si institucion drejtohem nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, neni 54, pika “m”, Ligji nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, date 19.02.2015), dhe VKB nr.29, datë 04.07.2003 “Aprovim Titujsh Nderi” me kërkesë të Këshillit Rajonal të Urdhërit të Mjekut më datë 18.01.2022 me nr.305 Prot. për Z. Gëzim Lamaj, me profesion mjek, ku në kushtet e Pandemisë së Covid 19, duke ushtruar profesionin e mjekut, i përballuar me një numër të madh të infektuarish me virus, ku dhe ai u infektua dhe për këtë shkak ndërroi jetë, propozon dhënien e titullit të nderit për këtë doktor.

Mjeku specialist imazherist Z. Gëzim Lamaj, ka lindur dhe është rritur në qytetin e Beratit në 28/10/1958. Ai përfundoi studimet e larta me rezultate shumë të mira në degën Mjekësi e Pergjithshme, pranë Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tiranës, në vitin 1985. Më pas, doktor Gëzimi vazhdoi specializimin afatgjatë në degën ‘Imazheri’, ku në përfundim të studimeve mori titullin ‘Mjek Imazherist’.

Z, Gëzim Lamaj filloi punë në Spitalin Rajonal Berat në datë 01/01/1997. Në vijimësi ka kryer edhe kualifikimin 6 mujor për përdorimin e aparatit CT Scanner dhe në datë 20/08/2012 u emërua ‘Shef i Shërbimit të Imazherisë’.

Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së tij në detyrën mjek imazherist, u pa puna e përkushtuar dhe profesioniste ndaj pacientëve, duke përballuar një ngarkesë të madhe pune, duke iu përgjigjur në kohë çdo urgjence mjekësore. Profesionin e mjekut imazherist ai e ushtroi në Spitalin Rajonal dhe Poliklinikën e Specialiteteve Berat, deri në fund të jetës së tij.

Mjeku Gëzim Lamaj gjatë gjithë punës dhe karrierës së tij ka dalluar për formim profesional dhe ka patur rezultate të mira në treguesit e efencës së shërbimit; ai gjithnjë ka gëzuar respektin e kolegëve dhe të gjithë komunitetit me të cilin ndërvepronte çdo ditë.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E ARSIMIT KULTURËS DHE RINISË

Puna e tij ishte e pandërprerë edhe në momentet e vështira të përballimit të situatës së pandemisë së Covid – 19, ku ishte në krye të detyrës duke iu përgjigjur dhe duke përballuar emergjencat mjekësore.

Për sa më sipër, propozojmë:

Të miratohet propozimi i dhënies së titullit ‘Nder i Qytetit pas Vdekjes’  
Z, Gëzim Lamaj.

Faleminderit!

DREJTORI  
**Majlinda RAMAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

RELACION

**PËR SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 94 DATË 28.12.2021  
